

Shkodra dhe Shqipëria e kanë tashmë destinacionin e tyre europian të pushimeve. “Velipoja Grand Europa Resort” hapi dyert në një ceremoni të veçantë mes miqve të shumtë që ju bashkuan inaugurimit të një prej investimeve gjigante në brigjet e Adriatikut, i kompanisë “Xhenis Sh.p.k”. Prerja e shiritit u bë nga administratorja Belma Çela, njeriu që qëndroi në krye të kësaj sfide nga hapi i parë deri në finalizim, si dhe nga kryetarja e bashkisë Voltana Ademi.

Punimet që zgjaten rreth 5 vite, i kanë dhënë kësaj zone imazhin e munguar, atë të një destinacioni të vertetë turistik, ku ndërthuret magjishëm natyra, me artin që ka krijuar dora e njeriut. Sot, ky resort konkuron denjësisht me simotrat e tij në Europë e më gjërë, pasi cilësia dhe standartet më të larta gjejnë vend këtu. Administratorja Belma Çela, që dha këtë ide dhe e konkretizoi hap pas hapi, duke i qëndruar pranë nga projekti, tek gur-themeli i parë e deri tek kjo ditë e inaugurimit, ka arsye të ndjehet e realizuar, por edhe falenderuese për të gjithë bashkëpunëtorët që e ndoqen në këtë enderr të kthyer në realitet. Pas kësaj sfide ajo tashmë i kërkon edhe shtetit dhe të gjitha strukturave vendimarrëse të ecin në këtë rrugë, që turizmi të jetë prioritar, pasi ai gjeneron të ardhura, punësim dhe promovim për Shqipërinë.

Mes miqve special ishte edhe kryetarja e LSI Monika Kryemadhi, e cila e surprizuar nga ky resort, thotë se nga sot vendi ynë ka një arsye më shumë pse të krenohet, kjo falë largpamësisë së çiftit Çela.

Të ftuarit më pas nga bota e biznesit, pushtetit vendor dhe politikës, miq dhe të afërm të familjes Çela, investitorit të këtij resorti panë nga afër mjediset e brendshme dhe gjithçka çfarë ofron, ky investim i fjalës së fundit në fushën e hoteleri turizëm, që nga sot i ka ndryshuar imazhin turizmit Shqiptar kudo në botë. Velipoja Grand Europa Resort kthehet kështu në busullën që orienton turizmin, duke e futur në shinat e duhura dhe që në të ardhmen premtion të tjera risi, për ta bërë Velipojën zgjedhjen tuaj të parë. (Korrik 2018)

{artsexylightbox path="images/stories/ndertime/inaugurimi2018"}

Pamja nga Aqualand (Prill 2017)

{artsexylightbox path="images/stories/ndertime/aqualand2017"}

Pamja nga punimet e resortit (Gusht 2016)

{artsexylightbox path="images/stories/ndertime/gusht2016"/}

Pamja nga punimet e resortit (Nëntor 2015)

{artsexylightbox path="images/stories/ndertime/resort"/}

Pamja nga punimet e resortit (Gusht 2015)

{artsexylightbox path="images/stories/ndertime/gusht2015"/}

Pamja nga punimet e resortit (Bar Grand Europa Resort)

{artsexylightbox path="images/stories/ndertime/bargrandeuroparesort"/}

Pamja nga punimet e resortit (Maj 2014)

{artsexylightbox path="images/stories/ndertime/maj2014"/}

Pamja nga punimet e resortit (Shkurt 2013)

{artsexylightbox path="images/stories/ndertime/shkurt2013"/}

Pamja nga punimet e resortit (Nëntor 2012)

{artsexylightbox path="images/stories/ndertime/nentor2012"/}

Velipoja Grand Europa Resort do të sigurojë komoditet 5 yjesh, shërbime dhe luks të pakualifikuar, duke e bërë atë një nga destinacionet më të dëshirueshme turistike në Mesdheun Lindor. Akomodim i klasit të parë dhe objekte të kohës së lirë të dizenuara me përpikmëri duke përdorur materiale tradicionale dhe të qëndrueshme. Të gjitha banesat do të ndërtohen me një fokus në cilësi të jashtëzakonshme dhe vëmendje në detaje.

Velipoja Grand Europa Resort do të ofrojë specifikime të larta për vilat dhe apartamentet të cilat ofrojnë një strehë të mahnitshme dhe me çmimet më të arritshme në bregdetin e Mesdheut. Dizajn i thjeshtë dhe elegant

Ndërtesat dhe peizazhet në të gjithë resortin, kombinojnë thjeshtësinë dhe elegancën për të krijuar një vend të mrekullueshëm për pushime. Banesat rezidenciale kanë linja të pastra gjeometrike të plotësuara edhe nga fasadat me xhama, ballkonet dhe tarracat, të cilat së bashku krijojnë një ekuilibër të përsosur mes jetesës së brendshme dhe të jashtme.

Me një fasadë mbresëlënëse prej 800 m plazh privat dhe duke zënë një sipërfaqe prej 300.000m² (30 hektarë), Resorti turistik do të ndërtohet me një densitet të ulët prej vetëm 21% dhe ndërtesat do të jenë e ulëta me një lartësi maksimale prej 4 katesh drejt fundit të resortit.

Të gjitha banesat brenda fshatit turistik janë të rrethuara me kopshte të bukura, me pishina dhe me rrugë të izoluara për këmbësorë. I gjithë trafiku i automjeteve do të drejtohet përgjatë rrugëve në kufijtë e Rezortit, duke minimizuar kështu ndikimin e tyre mbi banorët dhe mysafirët.

Tashmë një nga Rezortet më të kërkuara bregdetare në Shqipëri, Velipoja Grand Europa Resort është një mundësi e jashtëzakonshme investimi për qiradhënie apo një zgjedhje e jetesës për ata që kërkojnë të blejnë një shtëpi pushimi.

{artsexylightbox path="images/stories/ndertime/resort"/}

{artsexylightbox path="images/stories/ndertime/KRRTRSH_Studimi_Pulaj_Final"/}

Merrni informacionet e fundit:

Plotësoni formularin e mëposhtëm për të marrë detaje mbi disponueshmëri aktuale planimetritë, çmimet dhe objektet e resortit turistik.